



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 2314/1 Prot.

Vlorë më, 28.08. 2026

VENDIM

Nr. 47, datë 28.08.2026

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES ZBATUESE PËR ADMINISTRIMIN
FINANCIAR TË PROGRAMIT TË STUDIMIT "SHKENCA ARKITEKTURORE
PËR TRASHËGIMINË"**

Në mbështetje të nenit 49, të Ligjit nr. 80/ 2015 "*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*", nenit 25 të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë; të nenit 6, pika 3, gërma "c", të Rregullores Financiare të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë; propozimit të Fakultetit të Shkencave Teknike dhe Natyrore, përcjellë me shkresën 455/3, datë 26.06.2026; si dhe referuar Vendimit nr. 38 datë 29.07.2026 të Senatit Akademik; Bordi i Administrimit në mbledhjen e datës 28.08.2026,

VENDOSI:

1. Të miratojë **Marrëveshjen Zbatuese për Administrimin Financiar të Programit Ndërkombëtar të Studimit me Diplomë të Përbashkët (Joint Degree) "Shkenca Arkitekturore për Trashëgiminë"**, ndërmjet Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë dhe Politecnico di Bari, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij.
2. Ngarkohet Administratori i Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, dhe Fakulteti i Shkencave Teknike dhe Natyrore, për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi, në përputhje me kompetencat dhe përcaktimet e Marrëveshjes Zbatuese.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Anëtarët

Alma Bakiu

Enida Pulaj

Elmira Kushta

Ledina Mançka

Orkida Hasani

KRYETAR

Saniela XHAFFERI